



Datë: 02.09.2025
Numër Protokolli: 5880/2025

A.nr.945/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi -Bajraktari- anëtare, si dhe Sabile Avdyli - në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.945/2025 të datës 23.05.2025, të parashtruar nga ankuesja N.A, kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.09.2025 mori:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.945/2025, e datës 23.05.2025 e parashtruar nga ankuesja N.A.

II.Mbetet në fuqi Njoftimin e datë 14.05.2025 nr.prot 897 për kandidaten fituese, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesja, N.A (referuar më tutje si ankuesja) me datë 23.05.2025 ka parashtruar ankesë, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës regjistruar nën shenjën A.nr.945/2025 e protokolluar me nr.3407/2025, kundër Njoftimit të datës 27.03.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPB-së për refuzimin e aplikacionit lidhur me procedurën e rekrutimit, Grupi i administrimit të përgjithshëm, pozita Zyrtar për Regjistrim Civil me numër Reference RN00016718, klasa e pozitës Profesional 2, numri i kërkuar 1.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 28.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek MPB të, ndërsa me datë 11.08.2025, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen administrative në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesa me nr. prot 3407/2025 e datës 23.05/2025; Njoftimin e datës 14.05.2025 NJMBNJ e MPB; Kopja e konkursit me nr. reference RN00016718; Njoftimi i datës 27.03.2025 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për refuzimin e aplikacionit; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 28.05.2025; Përgjigje në ankesë e datës

11.08.2025; Vendimi për emërimin e Komisionit për pranime Nr.557/2025 të datës 04.04.2025; Akt Emërimi i datës 01.07.2024 për A.V; Ndryshimi i Aktit të Emërimit i datës 22.11.2013 për A.A; Akt Emërimi i datës 01.07.2016 për F.L; Ndryshimi i Aktit të Emërimit i datës 01.12.2015 për A.M; Akt Emërimi i datës 01.08.2024; Akt Emërimi i datës 01.02.2013; Lista e kandidatëve të aprovuar lidhur me konkursin RN00016718, si dhe lista e kandidatëve të refuzuar; Verifikimi paraprak i datës 11.04.2025; Formularët e Vlerësimit individual të anëtarëve të komisionit të datës 07.05.2025; Njoftimi i datës 06.05.2025 për kandidatët që kanë kaluar testin me shkrim; Aplikacioni i datës 08.03.2025 për kandidaten N.A bashkë me dokumentet; Aplikacioni i datës 13.03.2025 për kandidaten E.N bashkë me dokumentet; Aplikacioni i datës 10.03.2025 për kandidaten A.P bashkë me dokumentet dhe Testi me shkrim për kandidaten A.P.

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është **e pabazuar**, sepse:

Ankuesja në ankesën me numër protokolli 3407/2023 të parashtruar më datë 23.05.2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 27.03.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPB-së për refuzimin e aplikacionit lidhur me procedurën e rekrutimit, Grupi i administrimit të përgjithshëm, pozita Zyrtar për Regjistrim Civil me numër Reference RN00016718, klasa e pozitës Profesional 2, në Klinë pretendon se është shkelur Rregullorja QRK me numër Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, gjithashtu është bërë shkelje edhe e Ligjit me numër Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Ligjit me numër Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses ka konstatuar se kërkesat e përgjithshme formale të konkursit me numër reference RN00016718, të datës 14.02.2025, për Grupi i administrimit të Përgjithshëm për pozitën “Zyrtar për Regjistrim Civil” Profesional 2, Klinë, ku afati për aplikim ka qenë i hapur nga data 15.02.2025 deri me datë 16.03.2025, ndërsa kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit (Bachelor); Arsimi i lartë i paspecifikuar.. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1(një)vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.**

Në kuptim të kërkesave të përgjithshme formale për pranimin e zyrtarëve publikë të paraparë me nenin 9 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, konkretisht me paragrafin 1, përcaktohet se: “Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji”, ndërsa sipas nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: “2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurrimit, kandidatët duhet të bashkëngjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1.. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion”.

Bazuar në dispozitat e cekura më lartë, e që kanë të bëjnë me kërkesat për pranim në shërbimin civil, Kolegji i Këshillit, konstaton se në bazë të provave të lëndës, konkretisht dokumentacionit që ka dorëzuar ankuesja, me rastin e aplikimit Kolegji për shqyrtimin e ankesave në baze të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja, nuk i ka dorëzuar dokumentet me rastin e aplikimit për e Grupi i administrimit të Përgjithshëm për pozitën “Zyrtar për Regjistrim Civil” *Profesional 2*, në Agjencin e Regjistrimit Civil/Drejtorati i Pajisjes me Dokumente -Klinë, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku ky fakt është vërtetuar edhe në bazë të dëshmive të ofruara nga organi i punësimit gjegjësisht në bazë të aplikacionit të tij e po ashtu edhe në bazë shkresës të datës 27.03.2025 të dërguar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, andaj bazuar në vlerësimin e dëshmive si me sipër, dhe fakteve të lartë përmendura, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se në rastin konkret ankuesja me rastin aplikimit nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi se e njëjta ka një vit përvojë pune pas diplomimit sepse bashkangjitur kopjen e ID /letërnjoftimit në dy kopje, siç është përcaktuar në pikën 3. të konkursit ku përcaktohet se ***Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1(një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.***Kolegji i Këshillit, konstaton se njoftimi i datës 27.03.2025 i kundërshtuar me ankesë, është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse i njëjti është nxjerr në frymën ligjore dhe mbi bazë të gjendjes faktike dhe duke u respektuar kompetenca dhe hierarkia ligjore e përcaktuar me nenin 39 paragrafi 7 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtaret Publike si dhe nenin 6 paragrafi 2 dhe nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet së: *7 .1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3. NjMBNj publikon në SIMBNj dhe uebfaqen e institucionit listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. 4. NJMBNj njofton kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për rekrutim, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e pa përmbushura jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve’’.*

Kolegji i Këshillit nga provat e lëndës që i posedon nga organi i punësimit dhe aplikacionin e ankueses ka konstatuar se ankuesja posedon: Diplomën e datës 13.09.2021 me Nr.4316/0921 të lëshuar nga kolegji Fama dhe mori gradën Baçelor i Arteve në Ekonomik me specializim në Menaxhment dhe me këtë përvojë pune: posedon Vërtetimin e datës 06.03.2025 me të cilin vërtetohet se e njëjta ka punuar nga data 01.11.2002 deri më 31.08.2009, prej datës 01.06.2011 deri më datë 31.11.2011 dhe prej datës 14.04.2015 deri më 01.06.2015, gjithësejtë 7 vite e 4 muaj e 16 ditë përvojë pune në SHFMU “Avni Zhabota “në Shtupelë, Marrëveshje për Shërbime të veçanta prej datës 09.07.2016-08.09.2016 në Ministrinë e Diaspores në pozitën Zyrtar regjistruar për hartimin dhe përditësimin e regjistrimit të Diaspores dhe Mërgatës në Klinë, andaj Kolegji i Këshillit ka konstatuar se e njëjta nuk e ka përvojën e punës pas diplomimit, kështu që e njëjta nuk e plotëson kriterin e përvojës së punës sipas konkursit me numër reference *RN00016718*, të datës 14.02.2025, për Grupi i administrimit të Përgjithshëm për pozitën “Zyrtar për Regjistrim Civil” *Profesional 2*.

Kolegji i Këshillit po ashtu ka shqyrtuar edhe dosjen e kandidatës fituese A.P e cila në aplikacionin e datës 10.03.2025 ka bashkangjitur: posedon Diplomën e datës 18.10.2020 me Nr.1707/20 të lëshuar nga Kolegji AAB në Prishtinë me të cilën dëshmohet se e njëjta ka përfunduar studimet me datë 30.06.2018 dhe mori titullin Baçelor i Shkencave në Menaxhment dhe Informatikë, Diplomën Master i Shkencës në Menaxhim Biznesi të lëshuar me datën 06.12.2022 nga Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë dhe me këtë përvojë pune: Vërtetimin e datës 04.03.2025 me të cilin dëshmohet se e njëjta prej datës 12.04.2023 deri më 31.11.2023 ka punuar si mësimdhënëse e lëndës së fizikës SHFMU ”Tre Dëshmorët” në Jashanicë, dhe Vërtetimin e datës 13.03.2025 me të cilën dëshmohet se e njëjta prej datës 16.02.2022 deri më

02.02.2024 e njëjta në kompaninë Ardijan Prekadin B.I ka punuar në regjistrimet e blerjes dhe regjistrimet e shitjes të cilën përvojë e dëshmon edhe me Pasqyrën e llogarisë së Trustit pensional. Kolegji i Këshillit, me qëllim të konstatimit nëse kandidatja e cila është shpallur fituese A.P ka analizuar dosjen e të njëjtës dhe ka konstatuar nga shkresat e lëndës se e njëjta ka plotësuar kushtet formale të konkursit RN00016718.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nënit 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.945/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses N.A;
- Ministrisë së Punëve të Brendshme (Sekretarit të Përgjithshëm, dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore);
- Arkivit të KPMSHCK-së.